



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 maj 2023
Nr. Ref.:RK 2183/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI59/22

Parashtrues

Burim Limani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 432/2021, të 7 dhjetorit
2021, të Gjykatës Supreme**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu -Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Burim Limani, me vendbanim në Komunën e Lipjanit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ekrem Agushi, avokat në Komunën e Prishtinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 432/2021] e 7 dhjetorit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 5181/17] të 16 qershorit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 73/17], të 29 shtatorit 2017 të Gjykatës Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 24 janar 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) e nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 prill 2022, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 10 maj 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. GJR. KI59/22] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues.
8. Më 13 maj 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë kopjen e plotë të vendimit të kontestuar.
9. Më 13 maj 2022, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
10. Më 13 maj 2022, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
11. Më 24 maj 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr. KSH. KI59/22] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

12. Më 19 maj 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë kopjen e plotë të vendimit të kontestuar.
13. Më 2 qershor 2022, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
14. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
15. Më 12 prill 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka shfrytëzuar një banesë, të cilën e kishte fituar babai i tij, Bajrush Limani si rezultat i marrëdhënies së atëhershme të punës me Komunën e Lipjanit. Ai kishte lidhur kontratë me Ndërmarrjen Komunale Banesore në Lipjan për blerjen e asaj banese, por gjykatat e atëhershme nuk ia kishin vërtetuar kontratën e shitblerjes. Pas vdekjes së tij, banesën e kishte shfrytëzuar bashkëshortja F. L., kurse pas vdekjes së saj shfrytëzimin e ka vazhduar pasardhësi i tij, respektivisht parashtruesi i kërkesës.
17. Më 15 shkurt 2006, Gjykata Komunale në Lipjan përmes Aktvendimit [N. nr. 3/2006], vërtetoi se parashtruesi i kërkesës ka të drejtën e blerjes së banesës dhe se e ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes së banesës. Gjykata Komunale në Lipjan përmes vendimit të saj ishte thirrur në Ligjin për Banimin, sipas së cilit, në banesën në pronësi shoqërore, bartësi i të drejtës së disponimit është i obliguar t'ia mundësojë bartësit të së drejtës banesore blerjen e banesës të cilën e shfrytëzon.
18. Ndërkohë, parashtruesi i kërkesës ishte tutje duke e shfrytëzuar banesën bashkë me njësitë kadastrale në sipërfaqen e oborrit të saj, të cilat janë pjesë të kontestuara, që sipas tij, i shërbejnë përdorimit të rregullt të banesës.
19. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore kundër Komunës së Lipjanit, duke kërkuar që t'ia vërtetojë të drejtën e pronësisë në pjesën e paluajtshmërisë të përbërë nga njësitë kadastrale [1742-3], [1740-5] dhe [1740-6]. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e Aktvendimit [N. nr. 3/2006] të 15 shkurtit 2006 të Gjykatës Komunale në Lipjan.
20. Më 29 shtator 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 73/17] refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se duke u bazuar në provat e administruara nuk është vërtetuar si parashtruesi kishte fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë e kontestuar. Gjykata Themelore, duke ju referuar Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore dhe provave të administruara, konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë në mënyrë të paraparë me ligj dhe se parashtruesi nuk ka mundur që të fitoj paluajtshmërinë kontestuese në bazë të paragrafit 4 të nenit 28 në lidhje me nenin 12 dhe 13 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore si dhe të nenit 14 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
21. Ndër të tjera, Gjykata Themelore arsyetoi se *"[...] ndryshimi ligjor i Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike që ka ndodhur në vitin 1996, me të cilin është fshirë neni 29 i Ligjit të sipërpërmendur nuk është i zbatueshëm, sepse çështja se a mund të fitohet e drejta e pronësisë në pronën shoqërore me parashkrim fitues ka qenë e mbuluar gjegjësisht e rregulluar me legjislacionin që ka qenë në fuqi deri më*

22 mars 1989, konkretisht me LMTHPJ, ku me nenin 29 të Ligjit në fjalë ka qenë e paraparë se mbi sendin në pronësi shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrim fitues. Mirëpo, kjo gjykatë konsideron se edhe nëse ndryshimet ligjore të vitit 1996 do të ishin të aplikueshme as mbi bazën e këtij ndryshimi ligjor pala paditëse nuk do të mund ta fitonte të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues në paluajtshmërinë kontestuese, sepse nga viti 1996 e deri në vitin 2011 kur pala paditëse ka parashtruar padi në gjykatë nuk ka kaluar afati 20 vjeçar i paraparë me nenin 28 paragrafi 4 i LMTHJP-së, kurse pas ushtrimit të padisë posedimi i paditësit mbi paluajtshmërinë kontestuese në kuptim të fitimit të pronësisë me parashkrim nuk është posedim me mirëbesim, prandaj nuk mund të ketë efektin e fitimit të pronësisë me parashkrim, sepse nga vet padia rezulton se pala paditëse e ka ditur se paluajtshmëria kontestuese evidentohet në emër të të paditurës, kurse nga aktvendimi [N. nr. 3/2006] i 15 shkurtit 2006 të Gjykatës Komunale në Lipjan rezulton se pala paditëse ka blerë vetëm banesën, e jo ndonjë pjesë të paluajtshmërisë kontestuese”.

22. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore paraqiti ankesë pranë Gjykatës së Apelit me pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të të drejtës materiale, me propozimin që të anulohet aktgjykimi i goditur dhe lënda të kthehet në rigjykim.
23. Më 2 prill 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 5181/17] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore me arsyetimin se drejt është vërtetuar gjendja faktike dhe drejt është zbatuar e drejta materiale.
24. Më 16 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion pranë Gjykatës Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, duke u thirrur në shkelje qenësore të nenit 182 të Ligjit për Procedurën Kontestimore si rrjedhojë e kundërthënieve të arsyetimeve me dispozitivin dhe përmbajtjen e provave në vendimet e të dy gjykatave dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
25. Më 7 dhjetor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 432/2021] refuzoi si të pabazuar revizionin me arsyetimin se drejtë është konstatuar gjendja faktike dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [E. Rev. nr. 432/2021] i 7 dhjetorit 2021 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 46 [Mbrojtja e e Pronës] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke theksuar se gjykatat e rregullta nuk i kanë respektuar standardet kushtetuese me rastin e përpilimit të arsyetimit të vendimeve të tyre. Sipas tij, Gjykata Themelore në Ferizaj ka përpiluar një arsyetim, i cili është i paqartë dhe kundërthënës me provat e shqyrtuara. Madje, sipas tij, nuk janë paraqitur fare arsye për faktet vendimtare. Gjykata ka arsyetuar të drejtën e pronësisë në banesë pa qenë fare objekt kontesti, ndërsa për thelbin e çështjes, që ka qenë e drejta e pronësisë në

paluajtshmërinë e njësisë kadastrale 1742-3, nuk ka paraqitur arsye lidhur me faktet që kanë qenë vendimtare për gjykim meritior.

28. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike me arsyetimin se gjykatat e rregullta i kanë injoruar disa prova, siç janë dëgjimi i dëshmitarit, dokumenti-kontrata, aktvendimi i formës së prerë, këqyrja në vend të ngjarjes dhe ekspertiza gjeodezike. Parashtruesi i kërkesës pretendon se si rrjedhojë e vlerësimit të gabuar të provave, gjykatat kanë arritur në përfundime të gabuara.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë interpretuar gabimisht nenet 28, 12, 13, 29 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore-Juridike dhe paragrafi 4 të nenit 14 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, për faktin se me provat e paraqitura është vërtetuar shfrytëzimi i pandërprerë i paluajtshmërisë së kontestuar dhe e njëjta i shërben ende përdorimit të rregullt të banesës. Andaj, parashtruesi i kërkesës vlerëson se gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të së drejtës materiale me rastin e interpretimit të gabuar të dispozitave të ligjeve përkatëse.
30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe Gjykata e Apelit në arsyetim ka kundërthënë me pjesën e dispozitivit dhe me përmbajtjen e provave të shqyrtuara. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thekson se *“gjatë procedurës së zhvilluar lidhur me kontratën për shfrytëzimin e banesës, sa i përket Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan si dhe dëshmime të dëshmitarëve Avdi Jashanica e Basri Bytyqi dhe dëshmisë së paditësit kanë paraqitur arsye kundërthënëse me përmbajtjen e këtyre provave të shqyrtuara si dhe me përmbajtjen e procesverbalit të seancës së shqyrtimit kryesor”*.
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se paluajtshmëria është send aksesor dhe ajo e ndjek fatin e sendit kryesor-banesës. Në këtë kontekst, parashtruesi pretendon se i takon e drejta e shfrytëzimit të përhershëm të paluajtshmërisë me arsyetimin se i takon e drejta e pronësisë mbi banesën.
32. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, pretendon se gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke bërë shpronësim në mënyrë jo të rregullt me arsyetimin se nuk janë marrë për bazë të gjitha rrethanat faktike, duke përfshirë faktin e të drejtës së pronësisë mbi banesën, mbi bazën e aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, nga e cila rrjedh e drejta e pronësisë edhe në paluajtshmëri.
33. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që (i) kërkesën e tij të shpallë të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë që Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [Rev. nr. 432/2021] i 7 dhjetorit 2021 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke e shpallur të njëjtin të pavlefshëm dhe duke e kthyer çështjen në rivendosje.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

Neni 46 **[Mbrojtja e Pronës]**

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.
4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 **(E Drejta për një proces të rregullt)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]"

Protokolli nr. 1 neni 1 [Mbrojtja e Pronës]

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.[...]

Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

36. Më tutje, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49 (Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

37. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 432/2021] e 7 dhjetorit 2021, të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

38. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikisht përcakton që:

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

39. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe në praktikën e Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*". (Shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si "*qartazi të pabazuar*" dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si "*qartazi të pabazuara*", Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 30 prillit 2020; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 275 deri më 304).
41. Në këtë kontekst, dhe në vijim, me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës në rrethanat e këtij rasti, vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke pretenduar të drejtat pronësore në ngastrat kadastrale [1742-3], [1740-5] dhe [1740-6] mbi bazën e Aktvendimit [N. nr. 3/2006], të 15 shkurtit 2006, të Gjykatës Komonale në Lipjan.

43. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë interpretuar gabimisht nenet 12, 13, 28, 29 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore Juridike dhe paragrafi 4 të nenit 14 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
44. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se "[...] me arsyetimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe arsyetimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, të cilat janë paraqitur në arsyetimin e aktgjykimeve të tyre, sheshazi del se këto arsyeime njëra me tjetrën janë në kundërtënie të plotë për sa i përket interpretimeve të dispozitës së nenit 14 al. 4 dhe dispozitës së nenit 10 al.4 të LPDTS-së (al.4 i kësaj dispozite në të cilën thirret kjo gjykatë nuk ekziston në LPDTS-së). me arsyetim se me dispozitën e nenit 14 al.4 është përcaktuar se "Të drejtat dhe detyrimet që kanë të bëjnë me sendin kryesor shtrihen edhe mbi sendin aksesor, përveç nëse ndryshe është paraparë me ligj dhe nga palët". Kjo dispozitë ligjore është interpretuar gabimisht nga gjykatat instanciale ngase paditësi në banesë, e cila bashkë me banesën e dëshmitarit Avdi Jashanica, nga Lipjani gjenden në kuadër të objektit të përbashkët banesor, e ka fituar të drejtën e pronësisë e cila në kuptim të dispozitës së nenit 10 al.1 të LPDTS-së është paluajtshmëri, sepse banesa a e cila është pjesë përbërëse e objektit ndërtimor është e lidhur me bazamentin tokësor të pjesës së sipërfaqes kontestuese, të cilat si njësi të veçanta janë pjesë përbërëse e paluajtshmërisë kontestuese - njësisë kadastrale, nr. 1742-3 me matje dhe përkufizime gjeodezike të konstatuara nga eksperti gjeodezisë Agim Cani, andaj banesa a dhe pjesa kontestuese e paluajtshmërisë nuk janë sende të luajtshme, por në raport njëra me tjetrën e ndjekin fatin e tyre të përbashkët, kudo që shkon sendi kryesor shkon edhe sendi aksesor, andaj në pajtim me nenin 18 të LPDTS-në paditësi si posedues ligjor i ndërgjegjshëm i kësaj paluajtshmërie e fiton pronësinë në paluajtshmërinë kontestuese, pasi që pjesa e paluajtshmërisë kontestuese është aksesor i kësaj banese".
45. Tutje, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjykatat e rregullta gabimisht kanë konstatuar gjendjen faktike meqë nuk kanë marrë parasysh edhe provat tjera si dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertizën gjeodezike, aktvendimin e formës së prerë.
46. Gjykata vëren se pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës në thelb ka të bëjë me shkeljen e nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së me arsyetimin se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre, duke refuzuar kërkesën e parashtruesit për vërtetim të pronësisë në pronën kontestuese, kanë shkelur të drejtat e tij pronësore mbi pasurinë që i takon përmes Aktvendimit [N. nr. 3/2006], të 15 shkurtit 2006, të Gjykatës Komunale në Lipjan.
47. Për të adresuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, Gjykata paraprakisht do të citojë nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke i paraqitur parimet e përgjithshme në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me të drejtën e pronës. Pas kësaj analize, Gjykata do të aplikojë parimet e përgjithshme që rrjedhin nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe GJEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret.
48. Në këtë drejtim, Gjykata së pari rikujton përmbajtjen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
1. "E drejta e pronës është e garantuar.
 2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
 3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë

eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet”.

[...]

Neni 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së:

1. *Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveç se për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*
2. *Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.*

a.1 Parimet e përgjithshme të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

49. *Përmbajtja e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe zbatimi i tij, janë interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës gjyqësore të saj, të cilës ashtu siç është theksuar më lart, Gjykata do t'i referohet në lidhje me interpretimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.*
50. *Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata së pari vlerëson se e drejta në pronë sipas paragrafit 1 të nenit 46 të Kushtetutës garanton të drejtën e posedimit të pronës; paragrafi 2 i nenit 46 të Kushtetutës përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës, duke specifikuar qartë se shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik; dhe, në paragrafin 3, garanton që askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, duke përcaktuar gjithashtu kushtet nën të cilat prona mund të shpronësohet (shih rastin e Gjykatës, [KI50/16](#), parashtrues *Veli Berisha dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 marsit 2017).*
51. *Ndërsa, sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata vëren se GJEDNJ ka konstatuar se e drejta pronësore përbëhet nga tri rregulla të ndryshme. Rregulli i parë, i cili përcaktohet në fjalinë e parë të paragrafit të parë dhe i cili ka natyrë të përgjithshme, formulon parimin e gëzimit paqësor të pronës. Rregulli i dytë, në fjalinë e dytë të të njëjtit paragraf përfshin privimin nga prona dhe ia nënshtron atë kushteve të caktuara; Rregulli i tretë, i cili përfshihet në paragrafin e dytë të këtij neni ua njeh shteteve, ndërmjet të tjerash, të drejtën për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, me zbatimin e atyre ligjeve që ato i konsiderojnë të nevojshme për këtë qëllim (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Sporrong dhe Lonrot kundër Suedisë, kërkesa nr. 7151/75, 7152/75](#), Aktgjykim i 23 shtatorit 1982, paragrafi 61; dhe rastin e Gjykatës, [KI86/18](#), parashtrues *Slavica Đorđević*, Aktgjykim i 3 shkurtit 2021, paragrafi 140).*
52. *Të tri rregullat e lartcekura nuk janë, megjithatë, "të ndryshme" në kuptim të të qenit të pandërlidhura. Rregulli dy dhe tre kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe prandaj duhet të interpretohen në*

dritën e parimit të përgjithshëm të parashtruar në rregullin e parë (shih rastet e GJEDNJ-së, [James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8793/79](#), Aktgjykim i 21 shkurtit 1986, paragrafi 37; [Beyeler kundër Italisë, nr. 33202/96](#), Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 98; dhe shih rastin e Gjykatës, [KI29/16](#), parashtrues “KOSBAU GmBH”, Aktvendim për papranueshmëri i 13 nëntorit 2017, paragrafi 35).

a.2. Aplikimi i parimeve të lartpërmendura në rastin konkret

53. Gjykata sjell në vëmendje pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës me arsyetimin se gjykatat e rregullta përmes vendimeve të tyre, duke refuzuar kërkesën e parashtruesit për vërtetim të pronësisë në pronën kontestuese, kanë shkelur të drejtat e tij pronësore mbi pasurinë që i takon përmes Aktvendimit [N. nr. 3/2006], të 15 shkurtit 2006, të Gjykatës Komunale në Lipjan.
54. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përgjatë gjithë procesit gjyqësorë pretendonte të drejtat pronësore në ngastrat kadastrale [1742-3], [1740-5] dhe [1740-6] mbi bazën e Aktvendimit [N. nr. 3/2006], të 15 shkurtit 2006, të Gjykatës Komunale në Lipjan.
55. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimeve për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës pretendon se gjykatat e rregullta i kanë interpretuar gabimisht edhe nenet 12, 13, 28, 29 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore Juridike dhe paragrafi 4 të nenit 14 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.
56. Përkitazi me pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës, më konkretisht pretendimi për të drejtat pronësore mbi pronën kontestuese, Gjykata vëren se të njëjtat ishin trajtuar në mënyrë të detajuar nga gjykatat e rregullta.
57. Në këtë kontekst, dhe specifikisht lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për privimin nga pronësia të pronës kontestuese, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 73/2017] të 29 shtatorit 2017, duke trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, kishte theksuar si në vijim:

“Gjykata pasi i ka vlerësuar thëniet e palëve ndërgjyqëse provat e administruara ka vendosur si në pikën I të dispozitivit e këtij aktgjykimi edhe atë nga këto arsye: më asnjërin nga provat e administruara nuk është vërtetuar se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë në paluajtshmëri kontestuese, në ndonjë mënyrë të paraparë me ligj në fuqi në Kosovë përfshinë: Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmesë të nxjerra në përputhje me to dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

[...]

“Mirëpo, kjo gjykatë konsideron se edhe nëse ndryshimet ligjore të vitit 1996 do të ishin aplikueshme as mbi bazën e këtij ndryshimi ligjore pala paditëse nuk do të mund ta fitonte të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues në paluajtshmërinë kontestuese, sepse nga viti 1996 e deri në vitin 2011 kur pala paditëse ka parashtruar padi në gjykatë nuk ka kaluar afati 20 vjeçar i paraparë me nenin 28, paragrafi 4 i LMTHJP-së, kurse pas ushtrimit të padisë posedimi i paditësit mbi paluajtshmërinë kontestuese në kuptim të fitimit të pronësisë me parashkrim nuk është posedim me mirëbesim, prandaj nuk mund të ketë efektin e fitimit të pronësisë me parashkrim nuk është posedim me mirëbesim, prandaj nuk mund të ketë efektin e fitimit të pronësisë me parashkrim sepse

nga vet padia rezulton se pala paditëse e ka ditur se paluajtshmëria kontestuese evidentohet në emër të të paditurës, kurse nga aktvendimi N. nr. 3/2006, datës 15.02.2006, i Gjykatës Komunale në Lipjan rezulton se pala paditëse ka blerë vetëm banesën, e jo ndonjë pjesë të paluajtshmërisë kontestuese.

Theksimi i palës paditëse se pronësinë e ka fituar në bazë të nenit 12 të LMTHJP-së është i pabazuar sepse neni 12 i Ligjit në fjalë flet për fitimin e së drejtës së shfrytëzimit mbi tokën në të cilën është ngritur ndërtesa dhe tokës që shërben për përdorimin e rregullt të asaj ndërtese derisa ajo të ekzistoj, pra kjo dispozitë nuk parasheh mundësinë që pronari i ndërtesës të bëhet pronar i tokës shoqërore në të cilën është ngritur ndërtesa.

Theksimi i palës paditëse se pronësinë e ka fituar në bazë të nenit 14, paragrafi 4 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore është i pabazuar, sepse neni 14 flet për çështjen e sendit aksesori, e që nga kuptimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se sendi aksesori është sendi i luajtshëm, kurse në rastin konkret objekt kontesti është sendi i paluajtshëm”.

58. Gjykata gjithashtu rikujton se Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 5181/17] të 2 prillit 2021, në kontekst të këtij pretendimi specifik të parashtruesit të kërkesës, kishte theksuar si në vijim:

“Me vlerësim të drejtë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë në mënyrë bindëse dhe në tërësi ka vërtetuar gjendjen faktike relevante për marrjen e vendimit të drejtë në këtë çështje juridiko-civile. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar nga provat e administruara dhe të vlerësuara se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet që të vërtetohet se paditësi ka fituar të drejtën e pronësisë në pjesën e paluajtshmërisë në përbërje prej njësisë kadastrale 1742-3 në sipërfaqe prej 190m². Kjo për faktin se posedimi për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues është i vlefshëm vetëm nëse është me mirëbesim, e në rastin konkret paditësit i mungon ky posedim, përkatësisht paditësi nuk është në posedim me mirëbesim, përkatësisht paditësi ka qenë në dijeni se e ka në shfrytëzim paluajtshmerinë shoqërore e cila është vërtetuar me të gjitha provat është evidentuar si-pronë shoqërore, pra paditësi e ka keqpërdorur mirëbesimin e kësaj paluajtshmërie dhe në këtë drejtim ai paraqitet si posedues me keqbesim. Prandaj, gjykata e shkallës së parë në këtë drejtim drejtë ka vërtetuar se nuk mund të fitoj të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues të paraparë me nenin 28 të LMTHJP-se, për shkak se par. 4 i këtij neni kërkon mirëbesimin për të fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues, e që në rastin konkret këtu paditësit i mungon mirëbesimi. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe dispozitën e nenit 29 të LMTHJP-së e cila është ndryshuar me ndryshimet dhe plotësimet e bëra në vitin 1996, duke fshirë këtë nen dhe se kjo ka të bëjë me rregullimin e raportet për të ardhmen dhe kjo dispozitë nuk ka ndikim prapa veprues.

59. Në fund, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 432/2021] të 7 dhjetorit 2021, në trajtim të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, kishte sqaruar si në vijim:

“Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, dhe pas arsytimit të dhënë për pretendimet ankimore refuzoi si të pabazuar ankesën e paditësit dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se

edhe theksimet e palës paditëse se pronësinë e ka fituar bazuar në nenin 12 dhe 13 të LMTHJP-së paraqitet si e pabazuar sepse neni 12 i Ligjit në fjalë flet për fitimin e së drejtës së shfrytëzimit mbi tokën në të cilën është ngritur ndërtesa dhe tokës që shërben për përdorimin e rregullt të saj derisa ajo të ekzistojë, pra nuk parasheh mundësi që pronari i ndërtesës të bëhet pronar i tokës shoqërore në të cilën është ngritur ndërtesa, ndërsa neni 13 i Ligjit në fjalë ka të bëjë me bashkëpronësinë. Prandaj, sipas gjykatës së shkallës së parë pretendimi i fitimit të pronësisë në bazë të nenit 10 Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat të Tjera Sendore paraqitet i pabazuar sepse kjo dispozitë rregullon shitjen e sendit aksesori e që në rastin konkret sendi aksesori është sendi i luajtshëm, kurse në rastin konkret objekt i kontestit është sendi i paluajtshëm”.

60. Në këtë aspekt, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta, në rrethanat e rastit konkret, kishin trajtuar dhe arsyetuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës. Të njëjtat, kishin trajtuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe kishin sqaruar se (i) Aktvendimi [N. nr. 3/2006] i 15 shkurtit 2006, i Gjykatës Komunale në Lipjan, dëshmonte se parashtruesi ka blerë vetëm banesën dhe jo ndonjë pjesë të paluajtshmërisë kontestuese; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk e ka provuar mënyrën e fitimit të pronësisë mbi pronën kontestuese meqë në bazë të certifikatës së pronësisë rezulton të mos jetë pronar legjitim i pronës, pasi që kishte dështuar ta regjistroj në librat kadastral; (iii) prona kontestuese evidentohet si pronë shoqërore; (iv) si dhe parashtruesit të kërkesës i mungonte baza ligjore e aplikueshme për të fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën kontestuese.
61. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në rastin e parashtruesit të kërkesës kishin analizuar gjerësisht provat e paraqitura dhe pretendimet e ngritura nga parashtruesi, dhe në fund kishin refuzuar ankesën e tij duke u bazuar në dispozitat përkatëse të LPK-së dhe Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore të vitit 1980, që ato i kishin konsideruar si relevante përkitazi me rrethanat e rastit konkret dhe me pretendimet thelbësore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.
62. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës aktualisht nuk është bartës i të drejtës mbi pronën e kërkuar; përkundrazi, ai ka kërkuar kthimin/regjistrimin në librat kadastral në emrin tij, një pronë e cila ishte në pronësi shoqërore ashtu siç ishte vërtetuar nga gjykatat e rregullta.
63. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës që ankohet për një ndërhyrje në një nga të drejtat e tij/saj pronësore duhet të tregojë fillimisht se një e drejtë e tillë ekziston. (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Pištorová kundër Republikës Çeke](#), nr. 73578/01, Aktgjykim i 24 tetorit 2004, paragrafi 38).
64. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës. Një qëndrim i tillë mbështetet në praktikën e GJEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Van der Mussele kundër Belgjikës](#), nr. 8919/80, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 23 nëntorit 1983 dhe [Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë](#), nr. 48321/99, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 9 tetorit 2003). Në fakt, neni 46 i Kushtetutës garanton të drejtën e pronës, por kjo e fundit nuk është e drejtë absolute dhe iu nënshtrohet kufizimeve. Në rastin konkret, gjykatat e rregullta kanë shpjeguar kufizimet e pronës dhe pronësinë e pronës kontestuese në raport me kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
65. Prandaj, parashtruesi i kërkesës mund të pretendoj shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, vetëm për atë sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me “pronën” e tij. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, “pronë” mund të jetë “pasuria ekzistuese”, duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë

“prishmëri legjitime” që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore (shih, rastet e Gjykatës [KI26/18](#), parashtruesi i kërkesës “*Jugokoka*” Aktvendimi për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2018, paragrafi 49 dhe rastin [KI156/18](#), parashtruesi i kërkesës *Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 52).

66. Gjykata, nga të gjitha shtjellimet e sipërtheksuara, në rrethanat e rastit konkret, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë Gjykatës Supreme. Megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
67. Gjykata rikujton qëndrimin e saj të përgjithshëm se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike, si dhe interpretimet përkatëse të dispozitave ligjore a ligjit, si rregull hyjnë brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë respektimin e standardeve dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë, dhe, rrjedhimisht, ajo nuk mund të veprojë si gjykatë “*e shkallës së katërt*” (shih, në lidhje me doktrinën e “shkallës së katërt”, rastin e GJEDNJ-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës \[DHM\], nr. 30544/96](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
68. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se interpretimi i së drejtës materiale dhe procedurale është detyrë parësore dhe bie brenda juridiksionit të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të tillë janë në përputhje me normativat dhe standardet kushtetuese.
69. Në dritën e fakteve të mësipërme, Gjykata e konsideron të nevojshme të vë në pah se parashtruesit të kërkesës i është mundur zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai kanë mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqes argumente dhe dëshmi që ai i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës kanë gëzuar garancitë procedurale të ngërthyera në konceptin e gjyqimit të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KI118/17](#), parashtrues *Sani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih rastin e GJEDNJ-së [Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).
70. Për sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se vendimet e gjykatave të rregullta që rezultuan në refuzimin e ankesës së tij janë marrë në mënyrë arbitrare. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se pretendimi i parashtruesit për shkeljen të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës, është qartazi i pabazuar mbi baza kushtetuese.
71. Bazuar në si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa në tërësinë e saj është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 12 prill 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani